



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR RI-VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË
FUNKSIONARIT PUBLIKË Z. ASLLAN DOGJANI, ME DETYRË DEPUTET I KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT
TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE".**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.03.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar	BIBA-	Kryetar
Hysen	OSMANAJ-	Zv/kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Gëzim	VELESHNJA-	Anëtar
Klement	ZGURI-	Anëtar
Vera	SHTJEFNI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Ri-Verifikimi i deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publikë z. Asllan Dogjani, me detyrë deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

BAZË LIGJORE: Neni 14, 15, i ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 144 i ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN



Nr. 74 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14.00: e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Asllan Dogjani, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas parashikimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", është *organi kompetent* për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:

- Deputet të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak.

Në zbatim të ligjit të sipërcituar brenda afati, (4 gusht 2016) të përcaktuar në pikën 5 të Kreut VI të Vendimit të Kuvendit nr.17/2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 29 korrik 2016, shqyrtoi të dhënat e pasqyruara në formularët e vetëdeklarimit për funksionarët publikë, deputet, ministra që nuk janë deputet dhe kryetarët e bashkive.

Në përfundim të shqyrtimit KQZ, ndonëse nuk mori vendim, në mënyrë publike vlerësoi se asnjë prej funksionarëve publikë të verifikuar nuk përfshihej në kushtet për ndërprerjen e mandatit dhe ndalimin e ushtrimit të funksionit, edhe pse të gjithë anëtarëve iu bë e qartë se një numër i caktuar subjektësh nuk kishin deklaruar në formular të dhëna të caktuara si ndryshime gjenealogjesh apo dënime të mëparshme.

Në një kohë të dytë, Prokuroria e Përgjithshme nëpërmjet Sektorit të Verifikimit të Integritetit, i kërkoi KQZ-së, në zbatim të nenit 8, pika 2 të ligjit nr.138/2015, verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për 10 funksionarë publikë.

Pas verifikimit të formularit në përputhje me nenin 15, pika 1 të ligjit 138/2015 dhe Kreu VI, pika 6 Kreu V, pika 3, germa b e Vendimit të Kuvendit nr.17/2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vendosi t'ia kalojë rastin për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme brenda 5 ditëve, në lidhje me mundësinë e evidentimit të të dhënave të tjera, të panjohura për KQZ-në. KQZ-ja, gjithashtu i dërgoi Prokurorisë së Përgjithshme analizën e plotë të të dhënave në formularët e vetëdeklarimit, dhe ose në informacion shtesë, të bëra nga funksionarët pas afatit ligjor, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, informacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile si dhe vlerësimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me shqyrtimin e këtij dokumentacioni.

Referuar shkresave nr.451/7.Prot, datë 13.03.2017 dhe nr. 456/11, datë 13.03.2017, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit të Integritetit në Prokurorinë e Përgjithshme, ka dërguar në KQZ, vendimet "Për rezultatin të verifikimit" përkatësisht për z. Tërmet Nuro Peçi me detyrë Kryetar i Bashkisë Tepelenë, dhe z. Adriatik Maliq Zotkaj me detyrë kryetar i Bashkisë Poliçan.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar nenit 15 të ligjit nr.138/2015, Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, është institucioni kompetent për shqyrtimin e rezultateve të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme.

Nga shqyrtimi i procesit të verifikimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme për dy funksionarët e sipërpërmendur rezulton se nuk ka asnjë të dhënë shtesë nga verifikimi i kryer, në lidhje me dënime me vendim gjyqësor të formës së prerë me vendime jopërfundimtare, masa sigurimit apo urdhëra dëbimi.



Nr. 74 I vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14.00: e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Asllan Dogjani, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Rezultati i verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme është bërë në bazë të dhënave të cilat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka vënë në dispozicion me shkresat përkatëse, apo të dhëna të konfirmuara dhe nga vendimet gjyqësore dhe vërtetimet gjyqësore të cilat Prokuroria e Përgjithshme i ka administruar në organet kompetente (Gjykata dhe Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve).

Në përfundim, rezulton se nga verifikimi i kryer nga Prokuroria e Përgjithshme, nuk ka të dhëna shtesë përveç sa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka patur në dispozicion prej kohësh.

Vlerësimi i Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me këto të dhëna është se: "subjektet deklaruese", z. Adriatik Zotkaj dhe z. Tërmet Peçi përfshihen në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit aktual si kryetarë bashkie të parashikuara në vendimin e Kuvendit, nr.17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndallmeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015,"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike."

Vlerësimi i Prokurorisë bazohet në Kreun, III, pika 3, ç) të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit, sipas të cilit formulari, (që plotësohet dhe firmoset nga subjekti vetëdeklarues), përmban një rubrikë ku detyrimisht pasqyrohet se "*Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të sjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/apo emërimi nga funksioni publikë.*"

Sipas arsytimit të Prokurorisë, këta subjekte, duke nënshkruar në faqen e dytë të formularit të miratuar me vendimin nr.17/2016 të Kuvendit, mbajnë përgjegjësi të plotë dhe janë të vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota në lidhje me të kaluarën e tij kriminale. Rrjedhimisht, fakti që në formularin e depozituar *brenda afatit* nuk është pasqyruar asnjë e dhënë në lidhje me dënime me vendim të formës së prerë (qoftë edhe me gjobë) i bënë këto subjekte të përfshihen në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit.

Nga verifikimi i dokumentacionit formularit të vetedeklarimit vërtetimit të gjendjes gjyqësore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se:

Bazuar në arsyetimin e Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me subjektet vetëdeklaruese z. Adriatik Zotkaj, kryetar i Bashkisë Poliçan dhe z. Tërmet Peçi, kryetar i bashkisë Tepelenë, rezulton se nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Asllan Dogjani, janë të njëjtat kushte, *pas:*

Z. Asllan Dogjani në formularin e vetëdeklarimit i është përgjigjur me "Jo" pyetjes së formularit "A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë...?", duke mos deklaruar asnjë rast, dënimi me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Nga shqyrtimi i vërtetimit të gjendjes gjyqësore, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezulton se z. Asllan Dogjani me vendim të formës së prerë, nr. 317, datë 24.11.2004 dhe nr. 97, datë 06.04.2005, nga Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër dhe Apeli Shkodër është shpallur i pafajshëm për veprën penale "Shpifje dhe përhapjen e qëllimshme e thënieve dhe të çdo informacioni që dihet se janë të rreme", parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal.

Kodi i Procedurave administrative në nenin 144 "Rishikimi", parashikon se:

1. *Rishikimi është mjete ligjor administrativ, me anë të të cilit kërkohet anulimi apo ndryshimi i një akti administrativ të nxjerrë apo nxjerrja e një akti administrativ të refuzuar, kundër të cilit ankimi nuk është më i pranueshëm për shkak të kalimit të afatit të parashikuar nga ky Kod.*



Nr. 74 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14.00: e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Asllan Dogjani, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

2. Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen dhe mund të dihen prej saj gjatë zhvillimit të Procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativë.

KQZ në mbledhjen e datës 29 korrik 2016, nuk e shqyrtoi duke nxjerr konkluzionin e verifikimit me një akt administrative, çështjen e mosdeklarimit në formularin e vetëdeklarimit të një vendimi për Pushimin e Gjyqimit për veprën penale të "Shpifjes dhe përhapjen e qëllimshme e thënieve dhe të çdo informacioni që dihet se janë të rreme", parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal, për z. Asllan Dogjani. Referuar nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative, duke qenë së sipas rezultatit të verifikimit nga Prokuroria e Përgjithshme ka disa të dhëna të reja, të cilat kanë rëndësi për çështjen duke e zgjidhur atë në themel, dhe në mënyrë përfundimtare, KQZ-ja duhet të rishikojë vendimmarrjen e tij të datës 29 korrik 2016, në lidhje me verifikimin e formularit të vetëdeklarimit për funksionarin publik z. Asllan Dogjani.

Në lidhje me arsyetimin e vendimit nga Prokuroria e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shprehet se:

Për sa i përket vlerësimit të të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Asllan Dogjani Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duhet t'i referohet:

Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligj nr.137/2015 "Për disa shtesa në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" e ndryshuar, konkretisht neni 6/1 dhe 45, paragrafi i tretë.

Neni 6/1

"Ndalohet zgjedhja, emërimi apo ushtrimi i një funksioni publikë në një nga organet e parashikuara në këtë Kushtetutë, ose të krijuara me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bëra në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute, nëse verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publikë, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit."

Neni 45, paragrafi i tretë

"përrjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit".

Ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe konkretisht nenit 2, nenit 3, nenit 5.

Neni 2

Ndalimi për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publikë 1. Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për:

a) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88 paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278 paragrafin e parë, të pestë e të gjashtë, 278/a, 282/a, 283,



Nr. 74 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14.00: e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Asllan Dogjani, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

283/a, 284/a, 287 i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal;

b) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 110/c, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/ç, apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në Kreun X "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve", të Kodit Penal;

c) kryerjen e një krimi, që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, për të cilin janë dënuar me jo më pak se 2 vjet burgim;

ç) për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim.

2. Ndallimi i parashikuar nga pika 1, e këtij neni, zbatohet edhe ndaj personave:

a) që janë dënuar me një vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë, apo për të cilët është vendosur masë sigurimi personal dhe/ose është lëshuar një urdhër kërkimi ndërkombëtar nga autoritetet e një prej këtyre shteteve, për kryerjen apo tentativën e kryerjes së një prej veprave penale, të parashikuara në pikën 1, shkronja "a", të këtij neni. Për personat që plotësojnë kushtet e këtij paragrafi, ndalimet zbatohen në përputhje me pikën 5, të nenit 10, dhe pikën 1, të nenit 16, të këtij ligji;

b) që janë dëbuar nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë, në lidhje me një prej rasteve të parashikuara në pikën 1, shkronjat "a", "b" dhe "c", të këtij neni, apo janë dëbuar për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike të shtetit përkatës.

Neni 3

Ndallimi për t'u emëruar në një funksion publikë

1. Për veprat penale të parashikuara në pikën 1, të nenit 2, të këtij ligji, personi nuk mund të emërohet apo zgjidhet në funksionet publike si më poshtë:

a) në organe kushtetuese apo të krijuara me ligj;

b) gjyqtarë ose prokurorë

c) në postin e zëvendësministrit apo të njëvlershëm me të;

ç) në postin e prefektit;

d) funksionarë politikë në kabinetet e drejtuesve të çdo institucioni kushtetues apo të krijuar me ligj;

dh) në Shërbimin Informativ Shtetëror dhe shërbime të tjera informative;

e) në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik si dhe drejtues të çdo niveli ne administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihet në shërbimin civil;

ë) në Policinë e Shtetit;

f) ushtarakë të forcave të armatosura, si dhe

g) në çdo post drejtues të kompanive që zotërohen plotësisht apo në maxhorancë ose administrohen nga shteti.

Neni 5

Vetëdeklarimi dhe verifikimi i të dhënave

1. Personat e parashikuar nga nenet 2 dhe 3, të këtij ligji, duhet të plotësojnë e të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit deklarojnë mosekzistencën e shkaqeve për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar.

2. Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për mosregjistrimin e kandidatit në zgjedhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo për mosemërimin nga organi përgjegjës sipas ligjit. Modeli i formularit të vetëdeklarimit miratohet me vendim të Kuvendit.

3. Formulari i vetëdeklarimit plotësohet vetëm nga personi që është subjekt i këtij ligji. Deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrembëruara përbën vepër penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal".



Nr. 74 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14.00: e vendimit

Për RI-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Asllan Dogjani, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në rastin e z. Asllan Dogjani, i cili nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit një vendim të formës së prerë për të cilin Gjykata ka vendosur Pushimin e Gjykimit, duhet ti jap përgjigje, pyetjes:

A kanë detyrim për deklarim funksionarët publikë që parashikon ligji nr.138/2015 të deklarojnë çdo lloj shqyrtimi gjyqësorë të bërë nga gjykatat shqipëtare, përtej parashikimeve kushtetuese dhe ligjore?

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i referohet së pari Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe më pas ligjit nr.138/2015. Kushtetuta, referuar nenit 45 paragrafi 3 të saj dhe ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 2 të tij parashikojnë se, përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për disa vepra penale të përcaktuar në mënyrë shteruese. Sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore të cituara më sipër, funksionarët publikë kanë detyrimin për të deklaruar të dhëna për dënime me burgim me vendim të formës së prerë, për me jo më pak se 6 muaj, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Funksionarët publikë nuk kanë detyrimin sipas nenit 2 të ligjit nr.138/2015 të deklarojnë vendime të formës së prerë për "Pushimin e Gjykimit".

Referenca e organit të prokurorisë, në lidhje me rastin në fjalë, nuk bëhet në mbështetje të parashikimeve kushtetutës dhe të ligjit, por bëhet në lidhje me vendimin e Kuvendit nr. 17/2016, pika 3, germa "ç" dhe formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues. Pikërisht kërkesa në rubrikën 1 të formularit të vetëdeklarimit i miratuar nga Kuvendi, është në tejkalim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore. Interpretimi i organit të prokurorisë bie ndesh haptazi me parashikimet e nenit 3 të ligjit nr.138/2015 ku janë caktuar shprehimisht rastet e ndalimit për t'u emëruar në një funksion publikë dhe referenca ligjore për ndalimin për emërim apo zgjedhje në funksionet publike të cituara në këtë dispozitë i referohet po ligjit dhe vetëm nenit 2, pika 1 të tij.

Neni 5 i ligjit parashikon:

- subjektet që kanë detyrimin për të deklaruar dhe
- përcakton se çfarë detyrimesh kanë këta persona.

Sipas kësaj dispozite detyrimi i subjekteve është që të plotësojnë dhe të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit duhet të deklarojnë mosegzistencën e shkaqeve për të mos kandiduar, për të mos u zgjedhur apo për të mos u emëruar. Shkaqet për të mos kandiduar, për të mos u zgjedhur apo për të mos u emëruar janë vetëm shkaqet e përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr.138/2015. Të tilla shkaqe dispozitat e sipërcituara kanë përcaktuar dënimin me burgim jo me pak se 6 muaj për kryerjen e një krimi brenda apo jashtë Shqipërisë, pasja e një mase sigurimi personal ose një urdhër kërkimi ndërkombëtar si dhe dëbimi nga territori i një shteti anëtar të BE, SHBA, etj.

Kjo do të thotë se subjektet vetëdeklaruese nuk kanë detyrimin që të deklarojnë çfarë do lloj vendime për "pushimin e çështjes", dënim me burgim apo çfarë do lloj tjetër dënimi, përveç atyre dënimeve për kryerjen e një krimi, me burgim për jo më pak se 6 muaj, si dhe masat e tjera të parashikuara nga neni 2, pika 2 e ligjit nr.138/2015.

Në asnjë rast ligji nr.138/2015 nuk parashikon se subjekti deklarues duhet të deklarojë gjithçka dhe çdo gjë, por ligji në parashikimet e tij është selektiv dhe shterues, sepse e lidh në mënyrë të posaçme detyrimin për deklarim sipas llojit të veprës penale që ka kryer subjekti vetëdeklarues dhe gjithnjë brenda rrethit të tyre veprave penale që vetë ligji nr.138/2015 parashikon.



Nr. 74 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14.00: e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Asllan Dogjani, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në rastin e subjektit vetëdeklarues z. Asllan Dogjani deputet i Kuvendit të Shqipërisë, vendimi për "Pushimin e çështjes" për veprën penale "Shpifjes dhe përhapjen e qëllimshme e thënieve dhe të çdo informacioni që dihet se janë të rreme", parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal, nuk përfshihet në parashikimet dhe ndalimet e nenit 2 të ligjit nr.138/2015.

Vendimi i Kuvendit nr.17/2016, pika 3, germa "ç" parashikon shprehimisht se: "*pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publikë*".

Pikërisht ky është parashikimi i vendimit të Kuvendit ku mbështetet edhe argumenti se; "subjekte të caktuara ndodhen në kushtet e ndalimit për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publikë", nga ana e organit të prokurorisë. Referenca formale dhe në mënyrë të shkëputur në këtë pikë të vendimit të Kuvendit është e gabuar sepse:

Së pari, nëpërmjet këtij parashikimi gjendemi në situatën që vendimi i Kuvendit ka parashikuar një rregull material, që në fakt, nuk është detyra e një vendimi që ka dalë për zbatim të ligjit dhe të Kushtetutës, të parashikojë rregulla materiale. Një parashikim i tillë është tipik ligjor. Sipas hierarkisë së normave të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta vendimi në fjalë nuk mund të zëvendësoj ligjin e aq më tepër Kushtetutën.

Sipas ligjit nr.138/2015 e konkretisht neni 6 të tij, pika 1, "*Kuvendi miraton me vendim rregullat e detajuara dhe afatet për plotësimin, dorëzimin, administrimin dhe publikimin e vetëdeklarimeve, si dhe për marrjen e masave për zbatimin e ndalimeve të parashikuara nga ky ligj*". Pra, me fjalë të tjera nuk mundet dot Vendimi, qoftë ky dhe i miratuar nga Kuvendi të parashikoj ndryshe nga sa ka parashikuar ligji, sikurse ka ndodhur në rastin në fjalë. Tejkallimi i parashikimeve nga ana e një akti më të ulët në hierarkinë e normave ligjore nuk mund ta bëjë të ligjshëm këtë parashikim.

Hierarkia e normave ligjore është parashikuar shprehimisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e konkretisht në nenin 116 të saj duke renditur si më poshtë:

"AKTET NORMATIVE Neni 116 i saj:

1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

- a) Kushtetuta;
- b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
- c) ligjet;
- ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

Vendimi i Kuvendit në këtë rast nuk përmendet fare, por duke konsideruar delegimin që ka bërë vetë ligjvënësi, theksojmë se, sa më sipër, primati i normës ligjore është i padiskutueshëm në raport me një normë tjetër më të ulët se ajo në hierarkinë e normave.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson se parashikimi i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, e konkretisht, pika 3, germa "ç", se: "*pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publikë*", do të duhet të zbatohet gjithnjë nëse pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta që kanë lidhje me veprat penale që parashikon ligji dhe në asnjë rast përtej tij.

Neni 2 i ligjit 138/2015 nuk e parashikon veprën penale "Shpifjes dhe përhapjen e qëllimshme e thënieve dhe të çdo informacioni që dihet se janë të rreme", të parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal", si nen që të përfshihet në fushën e ndalimit për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një



Nr. 74 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14.00: e vendimit

Për RI-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Asllan Dogjani, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

funkcion të lartë publikë, pra një argument shtesë për mospasjen e detyrimit të subjektit në fjalë për të deklaruar një vendim gjykate për një veprë penale që nuk përfshihet në rrethin e veprave penale që parashikon ligji nr.138/2015.

Sa më sipër është e lidhur ngushtësisht edhe me parashikimet e nenit 1 të ligjit 138/2015 "Qëllimi dhe objekti" ku parashikohet shprehimisht se: "1. Qëllimi i këtij ligji është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publikë të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar **PËR KRYERJEN TË KRIMEVE, SIPAS KËTIJ LIGJI**".

Pra, edhe vetë qëllimi i ligjit lidhet me parashikimet e ndalimeve të parashikuara shprehimisht prej tij dhe vetëm për veprat penale që vetë ky ligj parashikon dhe jo përtej tij.

Sa më sipër është argumentuar, reflektohet edhe në formularin e vetëdeklarimit të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Në formularin e vetëdeklarimit në faqen 3, pika III, pyetja 1 është si vijon:

Ekstrakt i formularit të vetëdeklarimit:

III. TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT

I. A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Të dhënat e vendimit gjyqësor				
Gjykata	Nr. dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë	Masa e dënimit me burgim	Vepra penale për të cilën jeni dënuar	
			Neni	Lloji



Nr. 74 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14.00: e vendimit

Për RI-verifikimin e deklaramëve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Asllan Dogjani, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në fakt, sikurse vihet re, pyetja është vërtet nëse subjekti është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, por përmbajta e saj zëbërthehet në tabelën që vijon dhe nuk duhet të merret e shkëputur prej saj. Dhe konkretisht, subjekti mbart detyrimin për të deklaruar gjykatën (e huaj apo shqiptare) që ka dhënë vendimin, numrin dhe datën e vendimit si edhe, në nënndarjen e tretë parashikon detyrimin për të deklaruar llojin e dënimit me burgim, gjë që shkon në rrjedhën logjike edhe të Kushtetutës edhe të ligjit 138/2015. Në asnjë rast subjekti vetëdeklarues, edhe sipas logjikës se si është ndërtuar edhe formulari nuk ka detyrimin të deklarojë një vendim gjyqësor ku është pushuar çështja.

Prokuroria vjen me konkluzionin se subjekte të caktuara përfshihen në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit pikërisht nën këtë parashikim të Vendimit të Kuvendit, duke injoruar kushtetutën dhe ligjin. Pra, thënë ndryshe, penalizimi në rastin konkret nga ana e organit të prokurorisë bëhet mbi bazën e një akti që ka dalë në bazë e për zbatim të ligjit, është njësoj sikur prokurori të bazojë ngritjen e akuzës duke u bazuar në Kodin e Procedurës Penale që është mjeti nëpërmjet të cilit prokuroria shkon drejt realizimit të dënimit të parashikuar, ky i fundit nga Kodi Penal, ose për të ruajtur hierarkinë me rastin në fjalë, me një udhëzim të Prokurorit të Përgjithshëm.

Të gjitha rendet shoqërore të shoqërisë njerëzore, nga më i thjeshti e deri tek ata më diktatorialët janë mbështetur mbi rregullat të shkruara apo të pashkruara qofshin ato dhe rregulli në këtë rast është ajo çfarë Kushtetuta dhe ligji kanë parashikuar shprehimisht.

"Nuk ka dënim pa ligj neni 7 i KEDNJ, "Vetëm ligji mund të urdhërojë një ndëshkim". Këto janë parime esenciale të shtetit të së drejtës.

Prokuroria e Përgjithshme ka tejkaluar parashikimet e ligjit nr.138/2015 dhe të vendimit të Kuvendit nr.17/2016 edhe në kuptim të mënyrës së ushtrimit të detyrës nga ana e saj. Konkretisht sipas parashikimeve të pikës 5, të Kreut V të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016

"Për efekt të verifikimit nëse personi është apo jo në kushtet e ndalimeve, sipas neneve 2 dhe 3, të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Prokuroria e Përgjithshme vepron si më poshtë:

a) Për personat e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë:

i) administrohet në rrugë zyrtare një kopje e vendimit gjyqësor të formës së prerë;

II) verifikohet nëse dënimi është dhënë për ndonjë nga veprimet apo mosveprimet që përmbajnë veprat penale të përmendura në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 2, të Ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Të njëjtin detyrim parashikon vendimi i Kuvendit edhe për rastet e personave të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas germave "b", "c", "ç" "d" dhe "dh". Pra, është detyrë e organit të prokurorisë t'i referohet ligjit dhe vetëm ligjit, gjë të cilën sikurse shpjeguam më sipër, prokuroria nuk e ka bërë.

Në rastin konkret të z. Asllan Dogjani, duke shënuar me "jo" në rubrikën e parë të formularit, ka deklaruar se nuk ka asnjë shkak për të mos kandiduar, për të mos u zgjedhur, apo mos emëruar sepse pavarësisht se ka një vendim të formës së prerë "Pushimin e Gjykimit" për veprën penale "Shpifjes dhe përhapjen e qëllimshme e thënleve dhe të çdo informacioni qe dihet se janë të rreme", parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal, ky lloj vendimi nuk është shkak për të mos u zgjedhur, mos u emëruar apo për të humbur funksionin që ka.



Nr. 74 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14.00: e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Asllan Dogjani, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi analizoi rrethanat e çështjes, dëgjo pretendimet e z. Asllan Dogjani, vlerëson se z. Asllan Dogjani me detyrë deputet në Kuvendin e Shqipërisë nuk është në kushtet e parashikuara nga neni 2 i ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 14, nenin 15, të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 144 "Kodi I Procedurës Administrative".

VENDOSI:

1. Të shpall të pavlefshëm dhe përfundim e parakohshëm të mandatit të Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z. Asllan Dogjani.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Denar **BIBA-**

Kryetar

Bledar **SKËNDERI-**

Anëtar

Edlira **JORGAQI-**

Anëtare

Gëzlm **VELESHNJA-**

Anëtar

(Kundër)
(Kundër)
(Kundër)
(Kundër)



Nr. 74 i vendimit Data 23.03.2017 e vendimit Ora 14.00: e vendimit

Për Ri-verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë z. Asllan Dogjani, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".